

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

PROGRAMI I MENTORIMIT PER FUQIZIM POLITIK (PEER-TO-PEER)

OJQ “Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve” me numër të regjistrimit **5113364-1**, me adresë në Rr. “Ali Pashë Tepelena”, 10000 Prishtinë, të cilën e përfaqëson Drejtori Ekzekutiv, **z. Isak Skenderi**, lidhë marrëveshje bashkëpunimi me:

Komunën e Podujevës, me adresë në rr. “Nuhi Gashi”, Podujevë, Kosovë, e cila përfaqësohet nga Kryetari i Komunës, **z. Shpejtim Bulliqi**.

1. Qëllimi i marrëveshjes

- 1.1 Organizata “Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve” lidhë marrëveshje bashkëpunimi me Komunën e Podujevës për zbatimin e Programit të Mentorimit për Fuqizim Politik (peer-to-peer), i cili zbatohet në kuadër të projektit “Drejtësia Sociale”. Ky program mentorimi, me një kohëzgjatje prej tre (3) muajsh, synon përgatitjen profesionale të kandidateve të reja nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për angazhim aktiv në sferën politike dhe shoqërinë civile. Programi targeton kandidate të cilat kanë përfunduar shkollën e mesme të lartë apo edhe universitetin dhe të cilat janë aktive në komunitet dhe/ose janë të angazhuara në parti politike.

2. Përgjegjësitë e OJQ “Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve”

- 2.1 Do të bëjë përzgjedhjen e vajzave përfitueseve të Programit të Mentorimit për Fuqizim Politik;
- 2.2 Pas pranimi të raportit dhe timesheet-it mujor nga praktikantët, do të sigurojë pagesë mujore me vlerë dyqind e tetëdhjetë e pesë euro e shtadhetë e një cent (285.71) euro Bruto për tre (3) muaj për praktikantët, e cila do të bëhet përmes llogarisë bankare në emër të praktikantes;
- 2.3 Gjatë periudhës tre (3) mujore të programit të mentorimit do të realizojë vizita monitoruese të vazhdueshme.

3. Përgjegjësitë e Komunës së Podujevës

- 3.1 Do të ofrojë hapësirë të punës, mjetet teknike dhe pajisje funksionale, të përshtatshme, si dhe siguron të gjitha kushtet e tjera të punës në përputhje me rregulloret për sigurinë dhe shëndetin në punë për praktikanten që do të angazhohet për programin e mentorimit;
- 3.2 Do të sistemojë deri në dy (2) praktikante në komunë;
- 3.3 Do të përcaktojë një mentor/e për praktikantet, i/e cili/a do të bëjë mentorimin dhe udhëzimin e punëve në mënyrë të vazhdueshme gjatë kohës së angazhimit të praktikanteve;
- 3.4 Do të përcaktojë personin përgjegjës për kontaktim gjatë kësaj marrëveshje bashkëpunimi;
- 3.5 Do të përpiqet të ofrojë mundësi për ndjekjen e trajnimeve, seminareve, apo konferencave brenda ose jashtë vendit të punës, të cilat kanë për qëllim zhvillimin e shkathtësive profesionale, nëse këto mundësi janë të disponueshme gjatë periudhës së përcaktuar. Nëse këto trajnime kanë implikime buxhetore, shpenzimet do të mbulohen nga organizata VoRAE, përveç në rastet kur përcaktohet ndryshe;
- 3.6 Pas përfundimit të periudhës së punës praktike, do të bëjë vlerësimin e praktikanteve dhe, bazuar në fondet e disponueshme dhe performancën e treguar, mund të ofrojë mundësi punësimi;
- 3.7 Do të ofrojë përshkrimin e detyrave të punës ose planin e punës për praktikantet; Do të rishikoj dhe nënshkruaj raportet dhe timesheet mujore, të cilat do të përgatitjen nga praktikantet.

4. Politika PSEAH e Organizatës VoRAE

- 4.1 Të dy organizatat duhet të respektojnë politikën për parandalimin e shfrytëzimit, abuzimit dhe ngacmimit seksual nga momenti që kjo marrëveshje hyn në fuqi.

4. Puna e denjë:

4.1. **Ndjekja e punës me dinjitet** është një aspekt themelor i të drejtave të njeriut dhe drejtësisë sociale, duke synuar të sigurojë që të gjithë individët të trajtohen me respekt dhe të kenë mundësinë të bëjnë jetë të kënaqshme përmes punës dinjitoze

4.2. **Kushtet e sigurta dhe të shëndetshme të punës:** Punëdhënësit duhet të ofrojnë një mjedis pune të sigurt dhe të shëndetshëm pa rreziqe, duke siguruar mirëqenien fizike dhe mendore të punëtorëve.

4.3. **Mosdiskriminimi:** Të gjithë punëtorët duhet të trajtohen me respekt dhe dinjitet, pavarësisht nga raca, gjinia, feja, mosha, paaftësia, orientimi seksual ose ndonjë karakteristikë

4.4. **Siguria e punës:** Punëtorët duhet të kenë siguri të arsyeshme të punës dhe mbrojtje kundër largimeve arbitrare nga puna ose praktikave të padrejta të punës.

4.5. **Siguria sociale:** Duhet të vendosen kushte të përshtatshme të sigurisë sociale për të mbështetur punëtorët në kohë papunësie, sëmundjeje ose krize të tjera, duke siguruar që ata të mund të ruajnë dinjitetin e tyre edhe kur nuk janë të punësuar në mënyrë aktive.

4.6. **Arsimi dhe trajnimi:** Qasja në arsim dhe trajnim duhet të jetë e disponueshme për t'u mundësuar punëtorëve të përmirësojnë aftësitë e tyre dhe të përshtaten me kërkesat në ndryshim të punës.

4.7. **Qëndrueshmëria mjedisore:** Praktikrat e qëndrueshme dhe të përgjegjshme ndaj mjedisit duhet të promovohen në vendin e punës.

4.8. **Qasja në mjete juridike:** Punëtorët duhet të kenë qasje në mjete juridike dhe mekanizma efektivë për të adresuar shkeljet e të drejtave të tyre gjatë punës.

5. Kohëzgjatja e Marrëveshjes

5.1. Marrëveshja lidhet në periudhën 3 (tre) mujore dhe është e plotfuqishme prej datës së nënshkrimit më: 20.09.2024 dhe përfundon me datë: 20.12.2024;

5.2. Në rast të mos respektimit të detyrave dhe përgjegjësi të palëve marrëveshja mund të shkëputet nga secila palë me njoftimin paraprak prej 15 ditësh;

5.3. Marrëveshja është nënshkruar në dy (2) kopje origjinale në gjuhën shqipe, ku nga një (1) kopje ndahet për secilën palë nënshkruese.

PALËT NËNSHKRUESE

OJQ "Voice of Roma, Ashkali, and Egyptians"

Drejtori Ekzekutiv

Z. Isak Skenderi



Komuna e Podujevës

Kryetari i Komunës

Z. Shpejtim Bulliqi



Prishtinë, 2024